



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Poetika e Gjinive Letrare

Ngarkesa: 4 kredite (20 seminar + 20 leksion)

Viti / Semestri : Viti III/semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Francez

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti krijon dhe thellon teknikat e katër zhanreve letrare (Esesë, Poezisë, Teatrit, Romanit): Studjon dhe praktikon strategjitë argumentuese; studjon nën-zhanret e esesë ; organizon dhe përpilon ese argumentuese. Studjon dhe praktikon punën e poetit me gjuhën ; zhvillimin e formave poetike nga Mesjeta në letërsinë e sotshme; funksionet e poezisë; shkrimin kreativ dhe rishkrimin. Studjon dhe praktikon narracionin, përshkrimin si dhe elementët diskursivë të rrëfimit; analizon ndërtimin dhe kuptimin e personazhit romanesk. Studjon dhe praktikon komedinë dhe komikën, tragjedinë dhe tragjikën; risinë e formave teatrale në shekuj dhe përmbajtjen e shfaqjes teatrale.

Objektivat specifike lëndore:

1. Orientohet në levizjet dhe zhanret letrare në kontekstin historik, kulturor dhe ndërdisiplinar;
2. Analizon tekste të ndryshme të letërsisë dhe u pergjigjet pyetjeve të ndryshme;
3. Pasuron fjalorin, zotëron gjuhën dhe mjetet e analizës;
4. Përpilon shënimet mbi leximin e materialeve mësimore dhe bën sintezën e tyre;
5. Shprehet lirshëm në klasë: debat, prezantim, pyetje, etj.; Krijon punë të pavarur në grup dhe vetëm; Angazhohet në veprimtari krijuese.